

**Norma gjuhësore dhe substandardi në një tekst shqip
të shek. XVIII në arealin kulturor të Veriut**

Do kohë më parë fondi i kulturës së shkrimit shqip u pasurua me një tjetër tekst të vjetër, të shtypur dhe në dorëshkrim, i cili mbante veshur prej më se dy shekujsh e gjysmë pluhurin e harresës në arkivin historik të Kongregacionit të Shenjtë të Propaganda Fide-s. Zbuluesi i tij, arbëreshi Italo Sarro, historian dhe hulumtues i pasionuar i arkivave të Vatikanit pikasi menjëherë gurrën dhe motin e përafërt të hartimit të dorëshkrimit shqip (dhe italisht), ndërsa botuesi i tyre i parë, Ardian Ndreca mëngoi të saktësonte edhe emrin e autorit të dorëshkrimit. Ishte bash Imzot Gjergj Radovani, ipeshkvi i Dioqezës së Shkodrës, i cili aty nga fundi i vitit 1776 i drejtohej Kongregacionit të Shenjtë pér të miratuar dhe botuar përkthimin shqip të një tubëze lutjesh, më se të nevojshme pér t'i thënë besimtarët shqipfolës, në mënyrë që të merrnin ndjesën që kishte shpallur atëbotë Papa Klementi XIV. Krahas procedurës së miratimit, teksti i lutjeve i është nënshtruar – pas gjase – redaktimit ase korrekturës gjuhësore duke parë si i tillë edhe dritën e botimit në shtypshkronjën e Propagandës, institucion kulturor-fetar mbikëqyrës që mbulonte qëmoti nevojat e botimeve shqip pér arealin kulturor të Veriut katolik shqiptar.

I. Qerthulli problematik dhe diskutimi përkatës

Janë pikërisht këto rrethana që bëjnë që njohja, studimi dhe interpretimi filologjik e gjuhësor i këtij teksti të përcjellë një vlerë të shumëfishtë: Së pari: ai përmbyll sot pér sot fazën e parë të lëvrimit të shkrimit shqip në arealin kulturor të Veriut, i cili dallohet pér prurjet e tij në fondin e letërsisë së vjetër shqipe. Së dyti: kemi të bëjmë me një rast të parë në historinë e kulturës së shkrimit shqip brenda këtij areali, që një material gjuhësor e trashëgojmë në dy versione: në dorëshkrimin zanafillës dhe në formë të botuar, madje disponojmë edhe vetë tekstin burimor në gjuhë të huaj (italisht), në të cilin është mbështetur pas gjase përkthyesi ynë, Imzot Gjergj Radovani. Së treti: një ballafaqim sado i përciptë i materialit shqip bën më se të dukshme shmangjet grafike dhe gjuhësore që dallojnë tekstin e shtypur prej atij në dorëshkrim, aq

sa të krijon menjëherë përshtypjen se procesit të shtypit i ka paraprirë pas gjase ai i redaktimit dhe i korrekturës gjuhësore të gjegjësit në dorëshkrim. Hetimi i detajuar i këtyre shmangieve nga perspektiva të ndryshme filologjike-gjuhësore e tumir plotësisht këtë përsiatje të mprehtë të Ardian Ndrecës¹. Në këtë rast lejohemi t'i tërheqim vëmendjen lexuesit edhe me rrethanën se kemi të bëjmë këtu me ndërhyrjen e parë redaksionale në botimet e teksteve shqip që njohim deri sot. Së fundi shtojmë se ballafaqimi i dy versioneve shqip me njëri-tjetrin mundëson zgjerimin e analizës edhe për nga perspektiva sociolinguistike, d.m.th. me parë e hetuar, nëse ndërhyrjet në tekstin e shtypur dëshmojnë krahas zbatimit të një pakete kontrolluese rregullash drejtshkrimore edhe praninë e një norme gjuhësore, që gjellinte atëbotë brenda kornizës së mënjanimit të vetëdijshëm të ndonjë dukurie gjuhësore, të cilën lejohemi ta këqyrim fillimisht *ad hoc* si dëshmi e të ashtuquajturit substandard të shqipes së kohës në arealin në fjalë. Në këtë rast nuk bëjmë gjë tjeter, veçse rimarrim në analizë dhe zhvillojmë më tej me fakte gjuhësore një tezë që qarkullon qëmoti në debatin albanologjik,² ku mëtohet – pas gjase me të drejtë – prania në shekujt XVII-XVIII e një koineje të shqipes letrare me të gjithë komponentët e saj dallues, si p.sh.:

- me përhapje brenda një areali të kufizuar kulturor-gjeografik, e për rrjedhojë e mbështetur mbi një bazë dialektore: gëgnishten, por
- me prirje të qartë normëzimi që i kapërcen kufijtë e një të folmeje, qoftë kjo edhe e folmja e një qendre të fuqishme urbane të kohës, siç qe ajo e Shkodrës,
- me një paletë të kufizuar funksionesh, ndër të tjera: me përdorimin e saj në liturgji dhe në mësimin e dogmës fetare, në ushtrimin e së drejtës kanonike dhe administrative kishtare, në mësimin praktik të shqipes për klerin e huaj, në korrespondencën zyrtare me organet e pushtetit lokal,³ e që

¹ „Kah pikëpamja filologjike vërejmë disa mospërkimë ndërmjet dorëshkrimit dhe tekstit të shtypun. Ndonji sish asht shkaktue ndoshta thjesht prej pakujdesit të tipografisë, por ka mundësi që ndonji ndryshim të jetë i vullnetshëm, ba prej ndokujt që ka qortue shtypajt në Romë. Shtypajt mund t'i ketë qortue o ndonji student shqiptar i Propagandës ose ndonji ish-misionar apostolik.” (A. Ndreca: Nji tubëz lutjesh shqip e viti 1776, në: “Hylli i Dritës” 4 [2008] 161)

² Shih ndër të tjera Ismajli: Gjuha shqipe e Kuvendit të Arbënit (1706), Prishtinë 1985 11 vv., 244 vv.

³ Mjafton të përmendim këtu ndër të tjera trashëgiminë e kulturës së shkrimit shqip për këtë areal gjatë shek. e 18-të në a) botime, khs.: CONCIĀ PROVINTIAALI O CUNVENDI I ARBENIT. Mbegjëzime ndë viett gnai mijë fctat cint e tre, Romae 1706; Fr. Maria da Lecce: Osservazioni grammaticali ..., Roma 1716; G. B. Nicolouicch Casasi: Breve compendio della Dottrina Cristiana tradotta in lingua albanese ... Roma 1743, në Bardhyl Demiraj: Gjon P. Nikollë Kazazi dhe “Doktrina” e tij, Prishtinë 2006; dhe në b) dorësh-

- në varësi të këtyre funksioneve mëtonte legjitimitet duke kërkuar e gjetur mbështetje prej një instance të lartë institucionale, siç gjellinte atëbotë Kongregacioni i Shenjtë i Propaganda Fide-s, i cili mbartte përgjegjësinë e botimit dhe të shpërndarjes së teksteve shqip në arealin kulturor të Veriut katolik shqiptar.

Përmblodhëm kështu në mënyrë të thukët objektin dhe qëllimin e këtij studimi. Lidhur me metodën e punës mund të shtojmë gjithashtu se studimi orientohet drejt hetimit empirik të fakteve dhe mbështetet si i tillë në analizën filologjike dhe gjuhësore të tekstit, duke përshkuar kështu hap pas hapi disa fazë: (I) Një fazë e parë është digjitalizimi i tekstit, vështruar ky si riprodhim diplomatik i tekstit të shtypur dhe i versionit në dorëshkrim; (II) Faza e dytë ngërthen ballafaqimin e dy versioneve të tekstit shqip me njëri-tjetrin, gjë që na lejon të hetojmë dhe të izolojmë shmangjet grafike e gjuhësore ndërmjet tyre e që mundëson më pas kalimin (III) në fazën përfundimtare të studimit që është klasifikimi i tyre në grupe e kategori, duke ndërmarrë kështu njëherazi edhe interpretimin gjuhësor-filologjik për çdo rast në veçanti. Ndër këto grupime dallojmë:

- 1) punën redaksionale dhe korrekturën gjuhësore, parë këto:
 - a. si zbatim i normës gjuhësore në kodin alfabetik,
 - b. si ndërhyrje të vetëdijshme normative në drejtshkrimin e fjalëve a fjalëformave të ndryshme, që shfaqen në dorëshkrim me variacion grafik, ose syresh që – pas gjithë gjasash – janë parë e menduar prej korrektorit si variante të lira jonormative të ligjërimit të thjeshtë (= substandardit),
 - c. si stabilizim normativ i marrëdhënieve paradigmatike (në pjesët e eptueshme të ligjératës), ku synohet të përzgjidhet si normë gjuhësore një tufëz e caktuar shënjuesish gramatikorë, krahas rregullimit normativ të sjelljes gramatikore të gjymtyrëve në frazat me sintaksë të ngulitur,
 - d. si përdorim i kontrolluar i shenjave të pikësimit, që mund të këqyren deri diku edhe si përbërëse të normës sintaksore, e së fundi;
 - e. si ndërhyrje normative në përdorimin e shkronjës së madhe, kryesisht nëpërmjet zbatimit konsekuent të karaktereve simbolike në gjuhën e shkruar.

krite, khs.: Fr. Maria da Lecce: Dictionario Italiano – Albanese (1702 – dsh.). Botim kritik me hyrje dhe fjalës shqip, përgatitur nga Gëzim Gurga. Botimi I, Shkodër 2009; Mallkimet e t' Ejtes së Madhe (1704), në: Nevila Nikaj: Dioqeza e Shkodrës gjatë shek. XVIII sipas dorëshkrimeve arkivore, Shkodër 2001, f. 132, 222vv.; Letra e fretërve të Pultit (1761), në: Peter Bartl – Bardhyl Demiraj: Letra e fretërve të Pultit (1761) dhe vendi i saj në kulturën e shkrimit shqip në mes të shek. 18-të, në: "Hylli i Dritës" 4 [2008] 39 – 58, Shkodër etj.

- 2) Në një grup më vete mund të përfshijmë gabimet e dukshme në shkrim, duke dalluar mënjanë edhe lajthitjet e vetë korrektorit apo të radhitësit në procesin e shtypit.
 - 3) Një grupim të fundit mund të ngërthejë e ashtuquajtura korrekturë teknike, që lidhet me përpunimin për shtyp të materialit në dorëshkrim: titulli kryesor, nëntitujt e çdo lutjeje, organizimi i paragrafëve të veçantë, përzgjedhja e shkronjës së parë në tekstin e mirëfilltë etj.

Le të kalojmë tanë në shtjellimin e disa çështjeve që parashtruam më lart:

II. Tekstet dhe sistemi grafik që përcjellin ato

Riprodhimi i tekstit në dorëshkrim dhe i atij të botuar, të cilit i jemi përkushtuar në këtë rubrikë, nuk mund të quhet patjetër një hallkë e parë në analizën e tekstit. Përbushja e tij parakupton, ndër të tjera, shestimin dhe zgjidhjen e disa çështjeve që kanë të bëjnë me zberthimin e kodit alfabetik dhe njohjen e rregullave grafike e ortografike, të zbatuara në këto tekste. Paraqitja paraprake dhe rezultative e hulumtimit të këtyre çështjeve shpresojmë që të lehtesojë leximin dhe njohjen e tyre, ashtu siç mund t'i përcjellim më poshtë paralelisht në dy kolona, ku janë vënë përballë njëri-tjetrit teksti në dorëshkrim (djathas) dhe ai i botuar (majtas) në versionin zanafilës (= A. riprodhimi diplomatik), që pasohen nga rubrikat përkatëse për çështje të ndryshme të karakterit grafik dhe gjuhësor. Gjithsesi për çdo gjetje dhe interpretim lexuesi mund të marrë pjesë aktive në diskutim, duke bërë përqasjet e rastit me tekstin e transliteruar (B = transliterimi i zgjeruar) dhe faksimilen e ribotuar në fund të punimit.

	Kiofsc levdue o Əoti em , chi m' Kee krijue me kach t'mira .	Kiofsc levdue o Zoti em chi m'Kee Kriue me Kach t'mira.
15	Kiofsc levdue o Əoti em , chi m' kee şan ndè sceiten Fee tande .	Kiofsc levdue o Zoti em chi m'Kee şan nde sceiten Fee tande.
	Kiofsc levdue o Əoti em , chi m' kee scperblye scpjrtin me giak te Jesu- Krisctit melceriefcim .	Kiofsc levdue o Zoti em chi m'Kee scperblye scpjrtin me ghiak t'Jesu- Krisctit Misciriescim.
20	Kiofsc levdue o Əoti em , chi m' kee durue nderi sod me kach kate . T'luttem o Əoti em mem' forzue ndè	Kiofsc levdue o Zoti em chi m'Kee durue nderi sod me Kach Kate. T'luttem o Zoti em mem forzue ndè
(II)	Fee, Scpenès , e nde t' dasciunit tand, mem' rueit prei katit, prei hataasc, e prei għiġġ s' ligasc . <i>Puna e Fees .</i>	Fee, Scpenès e nde t'dasciunit tand, mem rueit prei Katit, prei hataasc, e prei għiġġ s'ligasc. [Puna e Fees]
25	Beflogg me għiġġ fuchij t'fciprit tem, fe asct gni Əot i vetem ndè trè Vet, chi Əżohen Ati , Bjri , e Scpjrti Sceit .	Befsoj me għiġġ fuchj t' Scipritit tim se asct gni Zot i vetim ndèr trè Vet, chi Əżohen Ati, Biri, e Scipriti Scejt .
30	Beflogg se Ibiri i Tènèzot Jefu Kriscti asct bâa Nieri pèr vertyt t'Scpjrtit Sceit; kaa dek mbè Kryq pèr nee; treten dit asct gnaall fe dekumit; e kaa me arċ me na gikue.	Befsoj se Ibiri i Tènèzot Jēsu Kriscti asct bâa nieri pèr virtyt t'Scpjrtit Sceit; Kaa dek mbè Kryq pèr nee : tretin dit u gnaal se deKunit : E Kaa me arċ mena ghikue.
35	Beflogg se Əotyn għimend ep t'mirv Parrjsin, e t' Kèchjve Ferrin pèr giġi mon .	Befsoi se Zotyn għimend ep t'mirve Parjsin, e t'Kèchjve Ferrin pèr ghiġi mon.
40	Beflogg se ndè sceitin Kunghim asct Je- fu Kriscti Əotyn , e Nieri Basck.	Befsoi se ndè Sceitin Kunghim asct Je- su Kriscti Zotyn, e Nieri Basck.
	Beflogg eġġe għiġġ chisc befsor sceitia Kjfc , pèrsè Kiscses ja kaa dèftue Əo- tyn chi asct vet e Verteta.	Befsoi eġġe għiġġ chisc befsor Sceitia Kjfc, pèrsè Kiscses ja kaa dèftue Zo- tyn chi asc vet Evèrteta.
(III)	 <i>Puna e Scpeneffes</i>	 [Puna e Scpeneffes]
45	Əoti em pèrsè jee i pusctuescèm, e fort i mèscèriescem, kam t'maġe usdai , fe kee mem' faal għiġi mbè- katet , mem' əsan fuchij me bamun veprà t'mira , e gni dit Parrjsin. E għiġi ktò i scpresġon per mundimè tē Jefu Krisctit , e pèrsè mi i kee prèmtue fine , chi jee bestaar, e i dreit ndè premtime .	Zoti em pèrsè jee i pusctuescèm, e fort i mèscèriescem, kam t'maġe usdai se kee mem fal għiġġi mbè- katet; mem əsan fuchij me bamun veprà t'mira; e gni dit Parjsin. E għiġi kettò i scpressi per mundime t'Jesu Krisctit, e pèrsè mi i kee prèmtue fine chi jee bestaar, e i dreit ndè premtime.

	<i>Puna e t'Dafctunit .</i>	[Puna e t'Dafctunit]
55	Əoti em përsè ti jee fort i dasciun , e mbj gięs t' mira vët i mir . Une t' due me gięs cembér, me gięs fuchij , e me gięs scpjrt : eşè pèr hatèr tand due Fèchignen , e sciochin si vet veten .	Zotì em përsè ti jee fort i dasciun, e mbj ghięs t'mirat vët i mir; Une t'due me ghięs zembér, me ghięs fuchj, e me ghięs Scpjrt: eşè pèr hatèr tand due Fèchin, e Sciochin si vet veten.
60	<i>Puna e t' źimtunit</i>	[Puna e t' źimtunit]
(IV)	Əoti em përsè ti jee fort i dasciun, e mbj gięs t' mira vet i mir , e përsè te due me gięs scpjrt, po pendòhem, e po m' vien këch me gięs cembér, se t' kam fejye. Mbescérièr o Əot, mbescérièr o Krisct. Prëmtögn me ndjm tandem përpara me dekun , se maa kurr me t' fejye.	Zotì em përsè jee fort i dasciun, e mbj ghięs t'mirat vet i mir, e përsè t'due me ghięs scpjrt, po pendòhem, e pom vien këch me ghięs zembér se t'kam fije. Mbescérièr o Zot, mbescérièr o Krisct. Premtöi me ndim tandem përpara me dekun se ma kurr met fije.
65	Jesu Krisct e Sceitia Mbrj Ama e Tenè- Eot juu falli scpjrtin tem . Kioft lèvdue Kriscti Pèr ghięs jet tè jetès . Amend . -----	Jesu Krisct e Sceitia Mbrj eama e Tinè- zot juu fali Scpjrtin tem. Kioft lèvdue Kriscti Pèr ghięs jet tè jetès. Amend.
70	Kusc i ęsot penduem, e me divozion, fitòn ndiesen , chi kaa ęsan Sceiti At Papa .	Kusc i ęsot penduem, e me divozion, fitòn ndiesen chi kaa ęsan Sceiti At Papa.
75		

III. Vijim dhe shhangje e normës gjuhësore në dorëshkrimin shqip

1. Përsosje e kodit alfabetik si pjesë e normës gjuhësore

Një vështrim sado i përciptë i dy versioneve të tekstit mjaftron për të dalluar menjëherë të ashtuquajturin "Alfabet i Propagandës", më se i njojur në botimet e dikurshme shqip me destinacion arealin kulturor të Shqipërisë së Veriut katolik⁴. Për këtë po mjaftohemi të kumtojmë përmbledhas, që:

- Alfabeti i përdorur në këto shkrime bazohet fund e krye në atë të latinishtes (mesjetare) dhe të italishtes, khs.: <a b c d e f g h i j k l m n o p r s t u v y z>. Njëloj si edhe në botimet shqip të arealit kulturor-fetar të Veriut, përdoren në versionin e botuar edhe tri karaktere grafike po

⁴ Që këtë edhe emërtimi "Alfabet i shkodranishtes së vjetër", shih Rrota 1936 69. Për një traditë të ngjashme të shkrimit shqip në zonën e Himarës shih së fundi B. Demiraj: Zef Skroi në kulturën e shkrimit shqip të shek. XVIII, në: "Studime" 12 [2005] 67vv.

aq tradicionale, por me tjetër burim: <γ ξ ε>⁵, ndërkohë që në tekstin në dorëshkrim shfaqet për herë të parë në mënyrë të rregullt grafema <z> (edhe) për të shënuar bashkëtingëlloren [z] = /z/.

b) Mjetet grafike të përdorura në kod përkojnë plotësisht me ato të praktikave gjuhësore në arealin kulturor të Veriut, i cili bazohet kryekëput në rregullat (orto)grafike të shkrimit të italishtes. Dallojmë këtu, ndër të tjera:

- Përdorimin e shkronjave <i> dhe <h> si mjete grafike.
- Përdorimin e theksave <'>, <^> si mjete grafike që u shkojnë përshtat rregullave të drejtshkrimit të italishtes së kohës. Theksin e rendë e ndeshim edhe mbi shkronjën zanore <è> që shënon krahas zanores së përparme [e] edhe të ashtuquajturën “e e pazanë” [ə], duke vijuar në këtë mënyrë traditën e ngulitur prej Pjetër Bogdanit në shkrimet shqipe të Veriut.⁶
- Pikësimi eshtë – sikurse pritet – i ndikuar tërësisht nga rregullat e drejtshkrimit të italishtes.

c) Llojet e grafemave në tekst përkojnë gjithashtu me ato të shkrimit shqip në arealin kulturor fetar të Veriut. Ndër to dallojmë:

- Grafema të thjeshta njëvlerëshe, khs.: <γ ε f t> = /y, z, f, t/.
 - Grafema të përbëra (digrame) njëvlerëshe, khs.: <ξ\xi aa gn> = /thā nj/, khs.: (29) <ξ\xohen> = /thohen/, (25) <hataafc> = /hatāsh/, (10) <Aξrògn> = /adhroni/ etj.
 - Grafema të thjeshta shumëvlerëshe (= me distribucion në varg), khs.: <g-A ~ g-E> = /g/ ~ /gj/, khs.: (25) <s' ligasc> ~ (25) <gi\x\x>, <giak>
 - Germat majuskula me përdorim jo vetëm në fillim fjalie dhe në emrat e përveçëm, por edhe për të shënuar institucionet dhe/ose nacione themelore teologjike, khs.: <Τeneξot>, < Sceitiet Pap Clement(i) Catèrmë\x\xeti(t)> etj.
- d) Krahas afrove të cituara më lart vërejmë edhe shhangje midis dy versioneve, të cilat bëhen më se të dukshme, kur marrim në analizë kodin alfabetik të zbatuar në secilin syresh, khs.:

5 Këto karaktere të veçanta nuk mungon t'i dallojë edhe Imzot Radovani në shënimet në fund të tekstit italisht, khs.: “La lettera ξ ha la forza della lettera greca Delta | La lettera ξ\xi ha la forza della lettera greca Θita | La lettera γ ha la forza del u franceze. | La lettera ε ha l'istesso suono, che la lettera s nella parola Musa.”

6 Të bie në sy gjithsesi mospërdorimi në të dyja versionet i shkronjës greke <λ> që futi si risi grafike Bogdani në veprën e tij. Shih së fundi A. Omari në: Pjetër Bogdani. Cuneus Prophetarum (Çeta e profetëve) – Botim kritik, Tiranë 2005 38vv., 59vv.

Alf. i Manast.	API	Tubëz lutjesh (dorëshkrim) 1776	Tubëz lutjesh (botim) 1776
a	[a] ~ [a:]	a ~ aa	a ~ aa
b	[b]	b	b
c (~ x)	[ts/dz]	z	z
ç	[tʃ]	?	?
d	[d]	d	d
dh	[ð]	ξ	ξ
e	[e] ~ [e:]	e, è ~ ee	e, è ~ ee
ë	[æ/ɜ/ə]	è, e	è, e
f	[f]	f	f
g	[g]	g-A, gh-E	g-A, gh-E
gj (~ xh)	[ɟ] (~ [dʒ])	ghi-A, gh-E	gi-A, g-E
h	[h]	h	h
i	[i] ~ [i:]	i ~ ij	i, y ~ ij
j	[j]	j, i	j, i
k	[k]	k, *C	k, *C
l	[l]	l	l, -ll-
ll	[ɫ]	l	ll
m	[m]	m	m
n	[n]	n	n
nj	[ɲ]	gn	gn
o	[o] ~ [o:]	o, ò	o, ò
p	[p]	p	p
q	[c]	ch	ch
r	[r]	r	r
rr	([rr])	r, rr	rr
s	[s]	s, -ss/(s-	s/f-, -s, -fs/ff-
sh	[ʃ]	sc-E, sci-A	fs/sc-E, fs/sc-A
t	[t]	t, *tt	t, *tt
th	[θ]	ξξ	ξξ
u	[u] ~ [u:]	u ~ uu	u ~ uu
v	[v]	v	v
y	[y]	γ ~ γγ	γ ~ γγ
z	[z]	z, -s-	ε, -s/f-

Në tabelën ë mësipërme vërejmë një përsosje të dukshme të kodit alfabetik në versionin e botuar të tekstit shqip, ku janë mënjanuar, d.m.th. redaktuar gjuhësish të gjitha ato raste me zgjidhje grafike dyfishë, si p.sh. për fonemat:

- /g/ dhe /gj/ para një zanoreje të përparme: (t. dsh. = teksti në dorëshkrim) <gh-E> pranë <g-A> ~ <gh-E> kundrejt (t. bot. = teksti i botuar) <gh-E> ~ <g-E> pranë <g-A> ~ <gi-A> = [g] ~ [j], khs. (t. dsh.) (25) <s' ligasc>, (39) <Kunghim> ~ (25) <ghiξξ>, (35) <ghikue>, (18) <ghiak> kundrejt (t. bot.) <s' ligasc>, (39) <Kunghim> ~ (25) <giξξ>, (35) <gikue>, (18) <giak> = /s[~]ligash/, /kungim/, /gjith/, /gjikue/, /gjak/ (: evtl. [j¹ak]).
- /l/ dhe /ll/: (t. dsh.) <l> kundrejt (t. bot.) <l, -ll-> ~ <ll> = [l] ~ [ɫ], khs.: (t. dsh.) (22) <T'luttem>, (72) <fali> ~ (34) <u gnial> kundrejt (t. bot.) <T'luttem>, <falli> ~ <u gnaall> = /t[~]lutem/, /fali/, /u njall/.
- /r/ dhe /rr/: (t. dsh.) <r> ~ <r, rr> kundrejt (t. bot.) <r> ~ <rr> = [r] ~ [rr], khs. (t. dsh.) (3) <her>, (14) <t'mira> ~ (4) <miret>, (37) <Parjsin>, (70) <kurr> kundrejt (t. bot.) <her>, <t' mira> ~ (4) <mirret>, (37) <Parrjsin>, (70) <kurr> = /her/, /t[~]mira/, /mirret/, /parrisin/, /kurr/.
- Si zgjidhje grafike dyfishe do parë edhe paraqitja grafike e fonemave /c/ dhe /z/ me <z>⁷ në tekstin në dorëshkrim kundrejt vijimit të traditës me <z> ~ <ɛ> në tekstin e botuar, khs. (t. dsh.) (11) <zot>, (57) <zembèr> ~ (22) <forzue>, (75) <divozion> kundrejt (t. bot.) <ɛot>, <ɛembèr> ~ (22) <forzue>, (75) <divozion> = /zot/, /zembér/, /force/, /divucion/.

2. Korrektura gjuhësore në zbatim të normës ortografike

Përpos ndërhyrjeve redaksionale të mësipërme që kushtëzohen në një formë a një tjeter me përmirësimet në kodin alfabetik, në versionin e botuar feksin fort aso shmangiesh që gjunjë shpjegim vetëm në rast se përsiasim si të mirëqenë korrekturën gjuhësore, që vjen me thënë zbatimin konsekuent të një pakete rregullash ortografike për shqipen letrare të kohës. Kështu mjafton të marrim në analizë ndonjë rresht në nëntitullin e tekstit për të krijuar një ide deri diku të plotë lidhur me korrekturën gjuhësore që është ndërmarrë para dërgimit të tekstit në shtyp, khs.:

- Rr. 4 (t. dsh.) <... t'ξohen miret ndiesa ...> ~ (t. bot.) <... t'ξohen, mirret ndieffa ...> = /... t[~]thohen, mirret ndiesa .../

Shënim: Përpos shtimit të shenjës së pikësimit <> ndeshim te ky rresht në tekstin e botuar tri korrigjime radhazi në drejtshkrim, që mënjanojnë pas gjase një lexim të gabuar, i cili do të tingëllonte pak a shumë si: *[t[~]ðohen | 'miret ndi'eza]

në vend të leximit korrekt [t'θohen | 'mirret ndi'esa].⁸

Ndërhyrje të kësaj natyre vërejmë edhe në ruajtjen e gjatësisë pas gjase "korrekte" të zanoreve në fjalëforma të tilla si: (t. dsh.) (27) <fuchj>, (47) <fal> kundrejt (t. bot.) <fuchij>, <faal>, sikurse (t. dsh.) (34) <gniaal> ~ (t. bot.) <gnaall> etj.

Rregullat drejtshkrimore ndihmojnë më tej jo thjesht dhe vetëm mënjanimin e shmangieve në shkrimin jokorrekt, por pas gjase edhe në konsolidimin e normës leksikore, duke shmangur kështu edhe ndonjë variant të gjuhës së folur, që i përket të ashtuquajturit substandard. E tillë është p.sh. fjalëforma e mbiemrit (t. bot.) <i vetem> "(i) vetëm", një formë pas gjase normative, me të cilën korrektori zëvendëson nga njëra anë gabimin e dukshëm drejtshkrimor (11) <i vëtëm> e nga ana tjetër variantin e ligjërimit të thjeshtë (28) <i vetim> që e ndeshim po ashtu në dorëshkrim. Në këtë grup mund të përfshijmë edhe korrekturna të tipit (t. bot.) (32) <vertyt>, (42) <Kifces>, (71-2) <Tenèl εot> kundrejt varianteve pas gjase të ligjërimit të thjeshtë (t. dsh.) <virtyt>, <Kifcis>, <Tinèl zot> etj.

3. Korrekturë në përdorimin e shenjave të pikësimit dhe të shkronjës së madhe

Korrektura gjuhësore vërehen gjithkund në versionin e botuar, sa i përket përdorimit të shenjave të pikësimit. Kështu p.sh., ndryshe nga përkthyesi, redakori parapëlqen përdorimin e rregullt:

- të presjes në parataksë ndërmjet gjymtyrëve homogjene me ose pa lidhësa bashkërenditëse, khs.: (t. bot.) (8-9) <T'Aξruemit , te Falunit Ndeers , e te Luttunit t' Teneεot>; si edhe në hipotaksë, khs. (t. bot.) (3-4) <E faa her | chi t'ξohen , mirret ndieffa ...>, (5-6) <... e Sctat Katérξeta , chi afct | ξanun prei ...>, (15) <Kiofsc levdue o εoti em , chi m' kee ξan ...> etj.,
- të pikëpresjes në vend të dy pikave, duke mënjanuar kështu shpesh edhe përdorimin e panevojshëm të shkronjës së madhe khs.: (t. bot.) (10-13) <afct bâa Nieri për vertyt t' Scpjrtit | Sceit; kaa dek mbè Krych për nee; | treten dit afct gnaall fe dekunit; e | kaa me arξ me na gikue .>,
- të pikës në fund të fjalisë, khs.: (t. bot.) (13) <... e mbj giξξ t' mira vët i mir .>,

⁸ Përndryshe nuk janë të rralla edhe rastet e lajthitjeve të shtypit ose të leximit jokorrekt të tekstit në dorëshkrim, si p.sh.: (t. bot.) (4) <te Sctat>, (18) <fcptjrtin>, (44) <e Scpenffees> kundrejt (t. dsh.) <p[er] Sctat>, <fcptjrtin> ose asaj që pritej *<e Scpenffes>.

- të apostrofit në rastet e shkurtimit të fjalëzave gramatikore, khs.: (t. bot.) (22-3) <... mem' forzue ndè | Fee ...>, (24) <mem' rueit prei katit>, (47) <... fe kee mem' faal gi\x\x ...>, (66) <... e po m' vièn kéch ...>, (70) <... se maa kurr me t' fejye.> etj.⁹

Redaktori ka ndërhyrë gjithashtu thuajse gjithkund në tekstin në dorëshkrim sa i përket:

- përdorimit konsekuent të shkronjës së madhe, kryesisht në shkrimin e emrave të përveçëm, të simboleve dhe nocioneve themelore teologjike, si p.sh.: (t. bot.) (11) <gnì \éot i vetem>, (71-2) <Sceitia Mbrj Ama e Tenè | \éot> kundrejt (t. dsh.) <gnì zot i vëtèm>, <Sceitia Mbrj eama e Tenè | zot>,
- mënjanimit të saj të panevojshëm në shkrimin e majuskulës <K> në trup të fjalës ose në fillim të saj, por brenda fjalisë, khs.: (t. bot.) (15) <... chi m' kee ...>, (20-21) <... chi m' kee | durue nderi sod me kach kate .>, (36) <... afct gnaall fe dekunit ...> kundrejt (t. dsh.) <... chi m' Kee ...>, <... chi m' Kee | durue nderi sod me Kach Kate .>, <... u gniaal se deKunit ...> etj.

4. Korrekturë gjuhësore si përmirësim ose zbatim i normës gramatikore

Në versionin e botuar të tekstit shqip vërejmë raste, ku mund të mëtohet një ndërhyrje e vetëdijshme redaksionale për përmirësim fjalëformash gramatikore, që mund dhe duhet të jenë konceptuar si variante të substandardit, përkatësisht si dukuri e ligjërimit të thjeshtë jonormativ, siç është p.sh.:

- përgjedhja e ndonjë fjalëforme foljore që dëshmon në ligjërimin e thjeshtë a) ndërrimin e klasës së foljes përkatëse, khs.: (t. bot.) (2) <me Scelbue> kundrejt (t. dsh.) <me Scelbye> “me salvuar”; b) të një kohe foljore brenda një diateze të caktuar, khs. (t. bot.) (34) <afct gnaall> kundrejt (t. dsh.) <u gniaal>; ose c) të vetë diatezës, khs. (t. bot.) (2) <meu dytun> = /me u ditun/ kundrejt (t. dsh.) <mei ditun> = /me i ditun/,
- përshtatja gramatikore e gjymtyrëve në frazat nominale, khs.: (t. bot.) (34) <treten dit> kundrejt (t. dsh.) <tretin dit>, apo në konstrukte sintaksore të tipit: (t. bot.) (6-7) <prei Sceitiet Pap Clement | Catërmë\x\x etit> = /prei sheitiet Pap Klemen\t Katërmëdhetit/ kundrejt (t. dsh.) <prei Sceitiet Pap Clementi | Catërmë\x\x eti> = /prei sheitiet Pap Klement-i Katërmëdheti/,

⁹ Nuk janë të rralla rastet, kur redaktori parapëlqen të shkruajë fjalëzën të plotë, pra pa e shkurtuar atë e për rrjedhojë të vendosë apostrofin, khs. (t. bot.) (64-5) <... përsë | te due me gi\x\x fcpjrt ...> kundrejt (t. dsh. <... përsë | t'due me gi\x\x fcpjrt ...>

- shkrimi i formës së plotë rasore të ndonjë emri të tipit (t. bot.) (59) <Fèchignen> = /fëqinjën/ kundrejt gjegjëses (t. dsh.) <Fèchin> = /fëqin/ që i takonte pas gjase ligjërimit të thjeshtë popullor.

Një rast më se i qartë i ndërhyrjes redaksionale, me synim ruajtjen e normës gramatikore-ortografike të fiksuar ndërkohë në traditën e shkrimit shqip, është shenjesi i vetës së parë njëjës të së tashmes dëftore të foljeve me temë në zanore <-gn> = {-nj} në versionin e botuar të tekstit, i cili zëvendëson në çdo rast variantin gjegjës <-i/j> = {-j} në versionin në dorëshkrim, khs. (t. bot.) (10) <T'aξrògn>, (27, 31, 36, 39, 41) <Befsogn>, (50) <scpresògn> kundrejt (t. dsh.) <T'aξròi>, (27) <Befsoj>, <Befsoi>, <scpressòi>. Redaktori ka mënjanuar kështu në mënyrë të vetëdijshme një dukuri të ligjërimit të thjeshtë popullor, që vjen me thënë të substandardit bashkëkohor, e cila erdhi e zuri vend përfundimisht në normën gjuhësore të shqipes letrare pas thuajse dy shekujsh, bash me hyrjen në fuqi të rregullave të drejtshkrimtit të shqipes falë Kongresit të Drejtshkrimtit të vitit 1972.

Facit

Me këtë dëshmi të fundit përfundojmë edhe studimin tonë duke shpresuar të kemi përbushur pak a shumë atë qëllim që i vumë vetes në krye të tij, pikërisht: a) të marrim në analizë prova konkrete të mëhershme në punën e mirëfilltë redaksionale me tekstet e vjetra shqipe; e nëpërmjet tyre b) të sjellim prova po aq konkrete që tumirin gjallesën e normës gjuhësore në koinenë letrare gege të shek. të 18-të; c) një normë kjo që mbikëqyrej, në mos edhe udhëzohej, prej një instance të lartë, përgjegjëse pér botimet shqipe në arealin kulturor të Veriut katolik shqiptar; d) ndërkohë që dëshmia e fundit sinjalizon njëherësh gjithë atë përvojë që ka përjetuar e përjeton norma gjuhësore në historinë e kulturës së shkrimit shqip, e cila rison traditën duke iu bashkuar substandardit në gjuhë, pikërisht kur ai është shndërruar ndërkohë në standard gjuhësor dhe motivon si i tillë një komunikim të kujdeshëm ndërgjuhësor.

Shtojcë I: Transkriptimi i zgjeruar i versionit të botuar

[f. 1] PUN T' NEVOISHIME

Me u ditun për me shelbue Shpirtin, e l shum her me u thanun. E sā her l qi t' thohen, mirret ndiesa p[ër] shtat l viete, e shtat katërdheta, qi asht l dhanun prei Sheitet Pap Klement l Katërmëdhetit .

T' Adhruemit, tē Falunit Ndērs, l e tē Lutunit t' Tenëzot .

|| T' adhronj o Zoti em, Ati , Biri , e l Shpirti Sheit , nji Zot i vetem l ndë[r] tre vet. || Kiofsh levdue o Zoti em , qi m' kē l krijue me kaq t' mira . || Kiofsh levdue o Zoti em , qi m' kē l dhan ndë sheiten Fē tandë . || Kiofsh levdue o Zoti em , qi m' kē l shperblye shpirtin me gjak te Jezu l Krishtit mesherieshim . || Kiofsh levdue o Zoti em , qi m' kē l durue nderi sod me kaq kate || T' lutem o Zoti em me m' forcue ndë [f. 2] Fē, Shpenes , e ndë t' dashunit l tand, me m' rueit prei katit, prei l hatash e prei gjith s' ligash . ||

Puna e Fēs .

|| Besonj me gjith fuqī t' shpirtit tem, l se asht nji Zot i vetem ndë tre vet, l qi thohen Ati , Biri e Shpirti l Sheit . || Besonj se i Biri i Tënëzot, Jezu Krishti l asht bām nieri për vertyt t' Shpirtit l Sheit; kā dek mbë Kryq për nē; l treten dit asht njall se dekunit e l kā me ardh me na gjikue. || Besonj se Zotyn njimend ep t' mirve l Parrizin, e t' këqive Ferrin për l gjithmon . || Besonj se ndë Sheitin Kungim asht Jel su Krishti Zotyn e nieri bashk. || Besonj edhe gjith qish beson Sheitia l Kish, përse Kishes ia kā déftue Zoltyn qi asht vet e Verteta. ||

[f. 3] Puna e Shpeneses

|| Zoti em përse jē i pushtueshëm e l fort i mëshërieshëm, kam t' madhe l usdai , se kē me m' fāl gjith mbë l katet , me m' dhan fuqī me bamun l vepra t' mira e nji dit Parrizin. E l gjith kto i shpresonj për mundime l tē Jezu Krishtit e përse m' i kē l premtue tine , qi jē bestar e i l dreit ndë premtue . ||

Puna e t' Dashtunit .

|| Zoti em përse ti jē fort i dashun l e mbi gjith t' mira vet i mir . l Une t' due me gjith zembër, me l gjith fuqī e me gjith shpirt ; edhe l për hatër tand due fëqinjen e l shoqin si vet veten . ||

Puna e t' dhimtunit

|| Zoti em përse ti jē fort i dashun, e l mbi gjith t' mira vet i mir , e përse l [f. 4] te due me gjith shpirt, po pendohem, l e po m' vien keq me

gjith zembër, l se t' kam fejye. Mbëshërier o Zot, l mbëshërier o Krisht.
Premtonj l me ndim tandem përpara me l dekun , se mā kurr me t'
fejye. || Jezu Krisht e Sheitia Mbri Ama e Tenëzot jū fali shpirtin tem ||
Kioft lëvdue Krishti || Për gjith jet të jetës . || Amend ||

Kush i thot penduem e me divocion, l fiton ndiesen qì kā dhan Sheiti |
At Papa.

Shtojcë II: Riprodhimi fotostatik i versionit të botuar

PUN T NEVOISCIME

Me u dytun per me Scelbue Scpjrtin, e scium ber meu ɻanun. E saa ber chi t' ɻohen, mirret ndieffa te Sstat Viete, e Sstat Katerɻeta, chi af ɻanun prei Sceitit Pap Clement Catermeɻetit.

T' Aɻruemit, te Edunit Ndeers, e te Lutunit t' Teneos.

T' Aɻrogn o Ʌoti em Ati, Byri, e Scpjrti Sceit, gni Ʌot i vete m nde t're Vet.

Kiofsc levdue o Ʌoti em, chi m' kee kriju me kach t' mira.

Kiofsc levdue o Ʌoti em, chi m' kee ɻan nde sceiten Fee tandë.

Kiofsc levdue o Ʌoti em, chi m' kee scperblse septjrtin me giak te Jesu Krisit mesceriescim.

Kiofsc levdue o Ʌoti em, chi m' kee durue nderi sod me kach kate.

T' luttem o Ʌoti em, mem' forzue nde

A

Fec

Puna e Scpenfsees.

Ʌoti em përsë jee i pulsuescem, e fort i mesceriescem, kam t' maže usdai, se kee mem' faal giɻf mbekatet, mem' ɻan fuchij me bamun veprà t' mira, e gni dit Parjsin. E giɻf klo i scpresidogn per mundimë te Jesu Krisit, e përsë mi i kee prëmtue tine, chi jec bestaat, e i drejt nde premtime.

Puna e t' Dafctunit.

Ʌoti em përsë ti jec fort i dasciun, e mbj giɻf t' mira vët i mit, Une t' due me giɻf embët, me giɻf fuchij, e me giɻf scpjrt: eze për hatë rand due Fechignen, e sciochin si vët veten.

Puna e t' ɻimunit.

Ʌoti em përsë ti jec fort i dasciun, e mbj giɻf t' mita vët i mir, e përsë te due

Fee, Scpenës, e nde e dasciunit tand, mem' rueit prei katit, prei hataast, e prei giɻf s' ligasc.

Puna e Fees.

Bessogn mè giɻf fuchij t'sepjrit tem, se asë gni Ʌot i vete m nde t're Vet, chi ɻohen Ati, Bjri, e Scpjrti Sceit.

Bessogn se Ibiri i Tëndët Jesu Krisit asë baa Nieri për verët t' Sepjrit Sceit; kaa dek mbë Krush për nec; treten dit asë gnaall se dekunit; e kaa mè arf me nà gikue.

Bessogn se Ʌotsn gnimend ep t'mirvë Parjsin, e t' Kechjve Perrin për giɻf mon.

Bessogn se nde sceitin Kunghim asë Jesu Krisit Ʌotsn, e Nieri Basck.

Bessogn eze giɻf chisc bessòn sceitia Kjlc, përsë Kisces ja kaa dëfue Ʌoten, chi asë vët e Vereta.

Puna

te due me giɻf scpjrt, po pendohem, e po m' vien këch me giɻf embët, se t' kam fejse. Mbëscerier o Ʌot, mbëscerier o Krisit. Prëmtogn me ndjm tandem përrpara me dekun, se maa kurr me t' fejse.

Iesu Krisit e Sceitia Mbrj Ama e Tëndët juu falli scpjrtin tem.

Kiost levdue Krisit

Për giɻf jet të jetës. Amend,

Kusc i ɻfor penduem, e me divozion, fiton ndiesen, chi kaa ɻan Sceiti At Papa.

Shtojcë III: Riprodhimi fotostatik i versionit në dorëshkrim

Dan t'nevoisuma mei aktien eet moe Leibler Sejjit, e sejum ha mua
qzanun. E ja a kerk hirt qoton mirat indiosa p' Sejat Vlora Sejat Katal
zota shi aset qanun rei Sejtit Berg Clementi Castimogeti.

T'azrai o Loti em Ati, Birri e Sejjiti sceit gni zot i volem neder træt,
Klofse lindue o Loti em chi m'Kee, kritis mei kach t'mira.

Klofse lindue o Loti em chi m'Kee qan ndi Sejten Devanda,

Klofse lindue o Loti em chi m'Kee q'jeribba, Sejjiti mei ghixiak t'lesur
Kriszt Misericordiem.

Klofse lindue o Loti em chi m'Kee dimes nederi sot mo kach Kater,

Nikhem o Loti em mem forzae ndi Beej, q'yanas i ndi l'lasunitt land, mem
ruet mai latit, jecu halanc, o jecu q'hixi t'sigase.

Għejji mei ghixi, fuċċi t'Sejjil him ser aset gni lot, v'ek im neder lu u, chi
jen Abi Birri e Sejjiti Seest.

Befor is-Sini i Ġineżot Jesu Kriszt aset bla niex p'er virtu t'Sejjil Seest
Kaa dekk m'bi kiekk jippec: Sejtin dit u għiġi sekkonni. E kaa mei
mena q'hixu.

Klofse is-Zotu qnimmend ip t'mirja Parju, e t'lekkie dherri p'er q'hixi mei
Klofse is-Sinjal Kunghom aset Jesu Kriszt Loti, e Marie Basile.

Eso p'er q'hixi chiex Sejjon Sejtiad kisej, jipper se Kriszt ja kaw diffirej,
Loti em chi asse vat eviex t-ta.

Loti em jipper se jec i-pusit u sciem, o fort i-mescieriem, Ramu t-insejje u ddai sejte
mem ful q'hixi mbe' kiekk; mem qan fuċċi mei Samu' yessra t'mir;

o għixha Parju. E q'hixi kato i-ġejja soċċi, ja minnha t'lesur kris-

ta jipper se mi ġie, ja minnha tħalli, ja minnha tħalli, ja minnha tħalli
Loti em jipper se t-jeo fort i-lasun, o m'h q'hixi t'mir u t'mir aktar t'

mei ghixi, zamol, mei ghixi fuċċi, o mo q'hixi Sejjit: qiegħi xejx baxx ta-

duu. Sejjin u Sejħin is-vi veteen.

Loti em jipper se fort i-daslu u m'h q'hixi t'mir u t'mir aktar tħalli
mei ghixi Sejjit, jejjandok hem, e jidu wiex kach mei ghixi Zamol so
t'kun f'għid, mei għo sejja, mħażżeek u rott, mħażżeek u idher. D'ixx tħalli
ndem kundu p'għajnej mōd aktar ja mħad luu m' f'id.

Jesu Kriszt e Sejtiha Mhix carna o Ĝineżot juu falli Sejjit t-tam.

Klofse lindue Kriszt

P'er q'hixi, ja tħalli. Annend

Kieni i-qiegħi, jendu u o mei divozion, fit-tin n'diesan chi kien qan Sejti ill-hax-

Deduzione

Chi L'incita contatta, o condivisione, guadagna l'Indulgenza concessa da
Santo Padre

SUMMARY

Unearthed by historian Italo Sarro and first published in *Hylli i Dritës* (2008), *A Collection of Prayers* (1776), by Msgr Gjergj Radovani has been providing food for thought for Albanologists for the past three years. It's further evidence of the fact that Albanian Gegh was rapidly developing a standard of written Albanian in 18th century.

This essay by Prof. Demiraj focuses on the differences between the manuscript and the published version broaching the idea of an already existing Albanian substandard in use among the Catholics and the Catholic clergy.